




Education for Everyone. Worldwide.
Lifelong.

Komuna e Vushtrrisë

OJQ "Hareja"



02Nr. PB 512 /25

Datë, 18.04. 2025

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT (MM)

Palët në MM:

1. **Komuna e Vushtrrisë**, Sheshi Ahmet Krasniqi / objekti i komunës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunes Z. Ferit Idrizi (më tutje në tekst: Komuna e Vushtrrisë),
2. **Organizata Joqeveritare Hareja – Vushtrri (OJQ - Hareja)**, me numër të regjistrimit 5101245-3, Rr Adnan Shyti Nr. Vushtrri, Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejshme referuar si: "OJQ –Hareja ") e përfaqësuar nga Z. Bajrush Kosumi - Përfaqësues Ligjor;
dhe
3. **Institut für Internationale Zusammenarbeit des Deutschen Volkshochschul-Verbandes e.V. (DVV)**, i regjistruar në Republikën e Kosovës, me numër regjistrimi 5300536-7, Rr. Rexhep Mala, Nr. 26, Prishtinë, 10000, Kosovë (në tekstin e mëtejshme referuar si: "DVV International") (www.dvv-international.de; www.dvv-international.ge), përfaqësuar nga z. Ramadan Alija, Drejtor Ekzekutiv i Zyrës dhe Projektit në Republikën e Kosovës:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është promovimi i arsimit të nxënësve për të rinj dhe të rritur, bazuar në parimet e barazisë dhe reciprocitetit, dhe konsolidojë përpjekjet për krijim të mundësive për pjesëmarrjen e të rinjve dhe të rriturve të Komunës së Vushtrrisë në ofertat holistike të arsimit joformal dhe formal dhe programeve të akredituara për të rinjtë dhe të rritur, që mbulojnë një shumëllojshmëri të gjerë të fushave dhe formateve. Ofertat arsimore do të zhvillohen në bazë të nevojave dhe interesave të banorëve të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Zotimet e Palëve

Sipas ligjit Nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur (AARr) në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenit 4 të këtij ligji i cili rregullon themelimin e ofruesve të programeve për AARr, dhe i cili specifikon se: “Organizatrat për Arsim dhe Aftësim për të Rritur themelohen nga institucionet publike, private, publiko-private, shoqatat, ndërmarrjet, organizatat joqeveritare dhe personat fizikë”, të tria palët në këtë MM, dakordohen për sa vijon:

1. Palët do të kontribuojnë në zhvillimin dhe zbatimin e ofertave arsimore me cilësi së lartë për të rinjë dhe të rritur (p.sh. kurse trajnimi profesional në fusha të ndryshme, kurse zhvillimi personal, praktika për zhvillim të përgjithshëm, edukim qytetar, demokratik dhe edukim kulturor, etj.) nga Komuna e Vushtrrisë.
2. Ofertat arsimore mund të ofrohen pa pagesë ose me pagesë. Të gjitha të hyrat nga pagesat e tarifave të mundshme nga trajnimet, do të përdoren për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të trajnimit dhe kompetencave menaxheriale të OJQ-Hareja dhe për organizimin e aktiviteteve arsimore për të rinjtë dhe të rriturit nga regjioni i Vushtrrisë.
3. OJQ-Hareja do të ndryshojë Statutin e vet dhe përveç të rinjve do të përfshijë edhe “të rriturit” si grup specifik i shënjestruar për të cilin do të ofrohen shërbimet përkatëse arsimore.

Neni 3

Kohëzgjatja

Ky memorandum i mirëkuptimit ka afat kohëzgjatjeje prej tri (3) vitesh nga dita e nënshkrimit.

Neni 4

Zotimet e Palëve

1. Komuna e Vushtrrisë zotohet për:

- 1.1. Ofrimin e shfrytëzimit të hapësirave të objektit të Qendrës Rinore në Vushtri , për OJQ- Hareja , për së paku 3 vitet e ardhshme, i cili duhet të jetë në gjendje të mirë pune , dhe me të gjitha komunaliet të disponueshme (ujësjellës, kanalizim, rrymë, internet etj).
- 1.2. Mbulimin e shpenzimeve mujore te komunalieve (ujësjellës, kanalizim, rrymë, internet, sigurim të objektit etj.) për së paku 3 vitet e ardhshme.
- 1.3. Merr përsipër të mos ndryshojë destinacionin e objektit dhe hapësirave të përcaktuara për OJQ – Hareja , për të paktën 3 vitet e ardhshme nga dita e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit;
- 1.4. Komuna e Vushtrrisë nuk merr përsipër asnjë obligim financiar nga buxheti i saj për sa i përket implementimit të kësaj marrëveshje, përveç pagesave të shpenzimeve të komunalive në objektin e Qendrës Rinore.
- 1.5. Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria për Kulturë rini dhe Sport do të caktoj një zyrtar për monitorim të zbatimit të kësaj marrëveshje.

2. OJQ Hareja Vushtrri zotohet për:

- 2.1. Zhvillimin dhe implementimin e programeve specifike edukativo-arsimore me qasje holistike për të rinjë dhe të rritur në fusha të ndryshme, si p.sh. aftësim profesional, gjuhë të huaja,

zhvillim personal, edukim mjedisor, tema të lidhura me shëndetin si shëndetin psikologjik dhe mendor, angazhimin qytetar, aktivitete kulturore etj;

- 2.2. Kryerjen e shërbime arsimore për të rinjtë dhe të rriturit në ambientet e veta në bashkëpunim të ngushtë me DVV International dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Vushtrrisë.
- 2.3. Monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ofruara, bazuar në treguesit e përcaktuar në planin vjetor të zbatimit dhe aktiviteteve; të dhënat e monitorimit dhe vlerësimit do t'i vihen në dispozicion DVV International dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Vushtri.
- 2.4. Zhvillimin e kapaciteteve të mëtejshme menaxheriale, si dhe të anëtarëve të stafit arsimor për të qenë në gjendje të mirëmbajnë në mënyrë profesionale organizatën dhe të kryejnë shërbime arsimore dhe edukative me cilësi të lartë për të rinjtë dhe të rriturit.

3. DVV International zotohet për:

- 3.1. Mbështetjen financiare për zhvillimin dhe implementimin e programeve / trajnimeve (kurseve) të ndryshme edukativo – arsimore për të rinjë dhe të rritur, bazuar në nevojat individuale të tyre dhe të komunitetit nga Komuna e Vushtrrisë ;
- 3.2. Sigurimin e asistencës dhe trajnimit profesional në fusha të ndryshme të menaxhimit organizativ dhe profesionalizimit të trajnerëve për ofrimin e trajnimeve (kurseve) për të rinjtë dhe të rriturit, dhe çdo fushë tjetër ku identifikohen nevoja për ngritjen e kapaciteteve të OJQ –Hareja në Vushtri .
- 3.3. Sigurimin e mbështetjes financiare për specialistët për edukimin dhe arsimimin e të rinjve dhe të rriturve, përfshirë udhëzimet dhe zhvillimin e programeve të trajnimit që do të përdoren në kuadër të aktiviteteve të OJQ Hareja - Vushtri .
- 3.4. Sigurimin e asistencës për transferimin e përvojave dhe bashkëpunimin ndërmjet OJQ-Hareja Vushtri dhe qendrave të tjera ndërkombëtare për arsimin e të rinjve dhe të rriturve.
- 3.5. Të gjitha objektivat strategjike dhe aktivitetet konkrete do të përshkruhen në një plan vjetor të zbatimit, të zhvilluar dhe akorduar nga DVV International dhe OJQ-Hareja Vushtri. Plani i zbatimit do të përmbajë objektivat, aktivitetet dhe treguesit specifik (të përcaktuar në mënyrë “SMART”) si dhe zotimet financiare. Ky plan vjetor duhet të përfundojë deri në fund të vitit kalendarik dhe të aprovohet nga drejtuesit e DVV International, dhe OJQ –Hareja .
- 3.6. Të gjitha aktivitetet e detajuara dhe buxheti i alokuar nga DVV International tek OJQ-Hareja , do të specifikohen në Marrëveshjet e Bashkëpunimit, të cilat duhet të nënshkruhen paraprakisht nga DVV International dhe OJQ-Hareja si palë të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

Neni 5

Zgjidhja kontesteve

1. Palët marrin përsipër të ruajnë informacionin konfidencial të marrë gjatë periudhës së zbatimit të Memorandumi të Mirëkuptimit;
2. Palët marrin përsipër të përmbahen nga veprimet që mund të shkaktojnë dëme morale, ekonomike ose të tjera për Palët tjera;
3. Çdo kontest ose pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë Memorandum të Mirëkuptimit do të zgjidhet në mirëbesim ndërmjet të tria institucioneve. Nëse kontesti nuk mund të zgjidhet në mënyrë informale, ai do t'i referohet një drejtuesi të lartë brenda secilit institucion.
4. Çdo kontest apo pretendim që nuk zgjidhet në mënyrë të kënaqshme për të tria institucionet pas përpjekjeve të mësipërme për zgjidhjen e kontestit, do të parashtrohet në gjykatë në Vushtri ose Prishtinë;
5. Nëse ndonjëra nga Palët nuk i përmbush detyrimet e veta sipas kushteve të këtij MM, Palët përgjegjëse duhet të informojë me shkrim Palët tjera të paktën dy muaj përpara;
6. Pas këtij njoftimi, palët tjera mund ta rishqyrtojnë pozitën dhe detyrimet e tyre, si dhe të ndryshojë

detyrimet e veta; ose me zgjedhjen e vet të lirë, të tërhiqen nga bashkëpunimi i mëtejshëm.

Neni 6

Ndërprerja dhe ndryshimi i këtij MM

1. Secili institucion mund ta ndërpresë këtë MM duke i dhënë njoftim me shkrim të dya institucioneve tjera të paktën tre (3) muaj para datës kur institucioni i tillë dëshiron ta ndërpresë MM-në.
2. Asnjë plotësim/ndryshim dhe modifikim i ndonjë dispozite të këtij MM nuk do të jetë efektiv përveç nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet siç duhet nga të tria institucionet.
3. Ky MM është hartuar në tri kopje në të dya gjuhët - shqip dhe anglisht. Secili institucion do të mbajë nga një (1) kopje nga të dya gjuhët.
4. DUKE DËSHMUAR SI MË LART, të tria institucionet kanë aprovuar që ky MM të zbatohet nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar siç parashihet.

Palët në këtë MM



OJQ - Hareja, Vushtrri

Z. Bajrush Kosumi - Përfaqësues Ligjor i OJQ-Hareja

Blum

DVV International

Z. Ramadan Alija - Drejtor Ekzekutiv i Zyrës dhe Projektit në Republikën e Kosovës.

Ramadan Alija